

AKT THEMELIMI

SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI KIJFIZUAR

"AR & LU MARMARA " SH.P.K

Në Berat , sot me datë 17/07/2023 (dymijë e njetetretë), redaktohet ky Akt Themelimi I Shoqërisë Private me Përgjegjësi të Kufizuar "AR & LU MARMARA" SHPK nga une kerkuesi :

- Z. Anxhelo Gjika , i biri i Valentinit , dtl. 14/09/1995 , banues ne Berat me adrese ; Lagja 30Vjetori Berat, i identifikuar , në bazë të Kartës së Identitetit me Nr 33232671, me nr.personal J50914068K.

I cili, bazuar në Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare të Ndryshuar" dhe nenet përkatëse të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë në fuqi, nëpërmjet këtij Akti Themelimi, themeloi Shoqërinë "AR & LU MARMARA" SH.P.K, e cila përbëhet nga nenet e mëposhtme:

KREU 1

Emërtimi, Forma Juridike, Selia, Kohëzqatia,Obiekti

Neni 1 Emërtimi

Emërtimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është SH.P.K.

Neni 2 Forma Juridike

Shoqëria "AR & LU MARMARA" SH.P.K, është person juridik i të drejtës shqiptare, Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (më poshtë e quajtur "Shoqëria").

Shoqëria "AR & LU MARMARA" SH.P.K, është një e tillë, kapitali i së cilës ndahet në kuota dhe ortaku përballon humbje vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit të tyre në kapitalin themeltar.

Neni 3 Selia

Shoqëria e ka selinë në adresën: .Lagja "Vodice "fshati Vodice Berat , 3 godina 1 kateshe ne fshatin Vodice Berat , Bashkia Berat .

Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyra përfaqësie, degë, të krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

Neni 4 Objekti

- ❖ Aktiviteti kryesor i shoqërisë është:
- ❖ Eksport-import e perpunim , veprimtari ne fushen gurit gelqeror, mermer, pllaka guri etj.,transport me shumicë e pakicë materiale te ndërtimi,vegla makineri e pajse, elektroshtepiake e cdo Iloj tjeter materiali qe perdoren ne fushen e

ndertimit, ndertimin e hidrocentraleve dhe ne Gdo fushe tjeter qe shoqeria e gjykon se eshte fitimprurese, etj. dhenie dhe marrje me qira pasuri te tundshme dhe te pa tundshme etj .Tregtim me shumice e pakice,import-eksport te artikujeve te ndryshem.Veprimtari ne fushen e ndertimit etj.

Neni 5
Kohézqiatia

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e sajë Për një periudhë kohore të pakufizuar.

KREU 11

KAPITALI

Neni 6
Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100 lekë (një qind lekë), i përbërë nga 1 kuote, me vlerë nominale 100. lekë.

Kapitali i mësipërm është nënshkruar nga ortakët e shoqërisë, Z. Anxhelo GJIKA i cili zoteron 51% te pjeseve te kapitalit dhe Gentjan KRRASHI i cili zoteron 49% te pjeseve te kapitalit.

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para Ose në natyrë (pasuri të luajtëshme/të paluajtëshme apo të drejta.)

Ortakët, që pengohen të ushtrojnë të drejtat që i rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, kanë të drejtë t'i kërkojnë gjykatës të urdhërojnë ndalimin e cënimit apo shpërblimin e démit të shkaktuar, si pasojë e cënimit të këtyre të drejtave. Kjo e drejtë parashkruhet brenda 3 vjetëve nga gastit i cënimit.

Neni 7
Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar Për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë. Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak Për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga Asambleja e Ortakëve, e Cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen Për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

Neni 8
Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- G) dhurimit;
- d) me akt notarial të shkruar
- e) Gdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Ky statut kushtëzon kalimin e kuotave të tretëve jashtë shoqërisë, me miratimin e shoqërisë dhe të drejtën e parablerjes në favor të shoqërisë apo të ortakëve të tjerë, sipas modaliteteve dhe shumicës së cilësuar që kërkon ndryshimi i statutit.

Përsoni që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë Për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga gasti i kalimit të kuotave, deri në castin e regjistrimit të kalimit të saj në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, sipas nenit 43 të ligjit Nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie. KREU 111

ORGANET VENDIMMARRËSE DHE DREJTUESE

Neni 9

Organi Vendimmarrës

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton Gdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e Përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse Për marrjen e vendimeve Për shoqërinë Për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e Administratorëve;
- q) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;d) përcaktimin e shpërblimeve Për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "q" të kësaj pike;

- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga Administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- é) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve; gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë ;
- i) Gësjtje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortakët mund të përfaqësohen në Asamblenë e Përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakëve në Asamblenë e Përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm Për një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, e Cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 10
Méhvra e thirries Sé mbledhies Sé Asamblesé Sé Pérqiithshme

Asambleja e Pérqjithshme thirret népérmjet një njoftimi me shkresé ose me njoftim népérmjet postés elektronike. Njoftimi me shkresé apo me mesazh elektronik duhet té pémbajé vendin, datén, orén e mbledhjes dhe rendin e dítés e t'u dérgohet té gjithé ortakéve, jo mé voné se 7 díté pépara datés Sé parashikuar Pér mbledhjen e asamblesé.

Kur Asambleja e Pérqjithshme nuk éshé thirur sipas pikés 1 té kétij neni, ajo mund té marré vendime tá vlefshme vetém nése té gjithé ortakét janë dakord, Pér tá marré vendime, pavarésisht parregullsisé.

Neni 11
Kuorumi

a) Né rastin e marrjes së vendimeve, qé kérkojnë një shumicé té zakonshme, asambleja e pérqjithshme mund té marré vendime té vlefshme vetém nése marrin pjesé ortakét me té drejté vote, qé zotérojnë më shumë se 30 Pér qind té kuotave.

b) Né rastin kur Asambleja e Pérqjithshme duhet tá vendosé Pér Géshtje, té cilat kérkojnë shumicé té kualifikuar sipas nenit 87 té ligjit "Pér Tregtarét dhe Shoqérité Tregtare", ajo mund té marré vendime tá vlefshme vetém, nëse ortakét qé zotérojnë mé shumë se gjysmén e numrit total té votave, janë tá pranishém përsónalisht, votojnë me shkresé apo mjete elektronike, sipas parashikimeve té pikés 3 tá nenit 88 tá kétij ligji.

Nëse Asambleja e Pérqjithshme nuk mund tá mblidhet Pér shkak té mungesés së kuorunit tá përmendur me lart, Asambleja mblidhet përsári jo mé voné se 30 díté, me té njëjtin rend dite.

Neni 12
Marria e vendimeve

Asambleja e Pérqjithshme vendos me tre té katértat e votave té zotéruesve té kapitalit tá ortakéve pjesémarrés, Pér ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogélimin e kapitalit tá rregjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqérisé.

Asambleja e Pérqjithshme vendos me shumicén e votave tá ortakéve pjesémarrés, Pér céshtje te tjera si:

a) pércaktimi i politikave tregtare té shoqérisé;

b) emérimin dhe shkarkimin e Administratoréve;

c) emérimin e shkarkimin i likuiduesve dhe tá ekspertéve kontabél tá autorizuar;

C) pércaktimin e shpërblimeve;

d) mbikéqyrjen e zbatimit té politikave tregtare nga administratorét, përfshiré përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe té raporteve té ecurisé se veprimtarisé;

e) përfaqésimin e shoqérisé né gjykaté dhe né procedimet e tjera ndaj administratoréve;

f) miratimin e rregullave procedurale tá mbledhjeve té Asamblesé;

Cdo ndryshim statuti duhet té depozitohet prané QKR Pér té pasyquar ndryshimet né skedén e shoqérisé.

Neni 13
Administrimi

Shoqéria do té administrohet nga një Administrator.

Administrator i shoqérisé éshé Z. ANXHELO GJIKA , i biri i Valentinit dtl 14/09/1995., Berat .

- Administratori do té ushtrojé detyrat e tij sipas statutit dhe ligjit Pér një periudhé 5 vjecare me té drejté ripértéritje.

Asambleja e Pérqjithshme mund tá shkarkojé Administratorét né Gdo kohé me shumicé tá zakonshme. Statuti apo marréveshje té tjera nuk mund tá përgjashtojné apo kufizojné kété té drejté.

Përveq kësaj, Administratorët shkarkohen nga gjykata Për shkelje të ligjit me kërkesë të Gdonjërit prej ortakëve. Tagrat e përfaqësimit të Administratorëve dhe Wo ndryshim i tyre njoftohen Për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

Emërimi i Administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit. Administrator i shoqërisë mund të emërohet edhe një person jashtë ortakërisë.

Neni 14 Kompetencat

Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) kujdesen Për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;

C) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet Për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme Për miratim;

d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur Për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë; dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, sic parashikohet në ligjin Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;

e) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posacme me rëndësi të veçantë Për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

Administratorët janë të detyruar të thërrasin Asamblenë e Përgjithshme edhe në rastet kur :

- Asambleja e përgjithshme thirret pasi, sipas bilancit vjetorë apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe
- kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 % të asetëve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të gertifikuara.

Administratorët kanë të drejtë të kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratorët përfaqësojnë Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private, vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkallëve.

Administratorët kanë të gjitha kompetencat Për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakëve të shoqërisë.

Administratorët angazhojnë shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i Administratorit/eve e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Neni 15 Përqiejësitë

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, Për shkelje të ligjeve, Për shkelje të statutit, apo Për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrévëshjeve të pamiratuara nga Asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrévëshjen, Për të përballuar në mënyrë individuale Ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveq sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", Administratori detyrohet:

1. a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;

b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;

c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;

ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;

d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse Administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta.

Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, Administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", kryen veprimet e mëposhtme:

a) u kthen ortakëve kontributet;

b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;

c) u shpërndan aktivet shoqërisë;

ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;

d) jep kredi.

Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, Administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", kryejnë veprimet e mëposhtme:

a) ti kthejë ortakëve kontributet;

b) ti paguajë ortakëve interesa apo dividendë;

c) te shpërndajnë aktivet shoqërisë;

C) te lejojë që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese Për të shlyer detyrimet;

d) jep kredi.

Përvec padisë Për shlyerjen e démit që i ngarkohet përsionalisht Administratorit, ortakët individualisht Ose sëbashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër Administratorit.

Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të démit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme.

Asnjë vendim i Asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit Për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

Neni 16 Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor.

Neni 17 Bilanci i shoqërisë dhe dividendet

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, Mbledhja e Ortakëve, Miraton Bilancin e paraqitur nga Administratori/et.

Mbledhja e Ortakëve vendos rreth shpërndarjes së dividendit, pasi të jenë zbritur humbjet e vitit të mëparshëm financiar, sic edhe parashikohet nga ligji.

Neni 18 Ekspertët

Eksperti ka Për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij Për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakëve.

Në përfundim të kontrollit, eksperti kontabel i autorizuar përgatit raportin me shkrim Për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe Për atë Për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ja paraqesë e dorezojë në kohë ortakëve Për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

Neni 19

Të ardhurat neto (Dividenti) që mbeten pas veqimit të fondeve ligjore të mësipërme dhe të atyre Për shlyerjen e Wo detyrimi fiskal apo likuidimin e pagesave ndaj të treteve, i mbeten dhe i kalojnë në pronësi të ortakëve.

Neni 20

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të behet në "o kohë:

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të Asamblesë së Ortakëve;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- G) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare Për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit Nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
- d) me vendim të gjykatës;

Në këtë rast, Ortakët marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar një apo disa likuidatore dhe shënuar në Gdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë "Shoqëri në likuidim e sipër".

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortakët.

Nëse Ortakët nuk marrin një vendim Për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, cdo përsone i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, Për të caktuar një likuidues.

Neni 21

Likuiduesi merr përsipër të drejtat dhe detyrimet e Administratorëve nga data e emërimit të tijë.

Nëse shoqëria emëron më shumë se një likuidues, përveçse kur akti i emërimit parashikon se ata veprojnë vegmas njëri-tjetrit, likuiduesit ushtrojnë bashkërisht të drejtat e detyrimet sipas këtij ligji.

Likuiduesit mund të autorizojnë njërin prej tyre të kryejë veprime të një kategorie të posacme. Kufizimet e tagrave të likuiduesve u kundrejtohen të tretëve, në përputhje me përcaktimet e ligjit. Likuiduesi u nënshtrohet mbikëqyrjes së ortakut dhe administratorit/eve.

Neni 22

Të drejtat e detyrimet e likuiduesit

1. Detyra e likuiduesve është mbyllja e të gjitha veprimeve të shoqërisë, mbledhja e kredive të paarkëtuara dhe e kontributeve të pashlyera, shitja e pasurive të shoqërisë dhe shlyerja e kreditorëve duke respektuar radhën e referimit, sipas nenit 605 të Kodit Civil.

2. Likuiduesi mund të kryejë edhe veprime të reja tregtare, Për mbylljen e një veprimi të papërfunduar.

3. Nëse, në bazë të padive të ngritura nga kreditorët, sipas nenit 194 të ligjit " Per Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare ", likuiduesit vérejnë se pasuria e shoqërisë tregtare, përfshirë kontributet e pashlyera, nuk është e mjaftueshme Për pagesën e këtyre pretendimeve, likuiduesit detyrohen ta pezullojnë procedurën e likuidimit e t'i kërkojnë gjykatës përkatëse nisjen e procedurave të falimentimit.

Likuiduesi përgatit një bilanc të gjendjes së shoqërisë në gastin e hapjes së likuidimit dhe një bilanc përfundimtar në gastin e mbylljes së këtyre procedurave. Nëse procedura e likuidimit zgjat më shumë se një vit, likuiduesi përgatit, gjithashtu, pasqyrat financiare vjetore të shoqërisë.

Neni 23

Përfundimi i likuidimit

Pas shpërndarjes së aktiveve të mbetura, likuiduesi e njofton Qendrën Kombëtare të Regjistrimit Për përfundimin e likuidimit dhe kërkon gregjistrimin e shoqërisë, në përputhje me seksionin V të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".

Neni 24 Ndaria

1. Një shoqëri mund të ndahet me vendim të Asamblese se Ortakeve, duke transferuar të gjitha aktivet e pasivet e veta në favor të dy ose me shumë shoqërive ekzistuese apo të themeluara rishtazi. Shoqëria që ndahet, vlerësohet e prishur.

2. Për ndarjen e shoqërisë zbatohen përkatësisht dispozitat e neneve 216 deri në 225 të ligjit 9901 datë 14.04.2008.

3. Regjistrimi i ndarjes së shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit ka si pasojë:

a) kalimin të shoqëritë pritëse të të gjitha aktiveve e pasiveve të shoqërisë që ndahet, në përputhje me raportin e ndarjes, të përcaktuar në marrëveshjen e ndarjes. Ky kalim sjell pasoja Për marrëdhëniet ndërmjet shoqërive, si dhe Për palët e treta;

b) bërjen e aksionarëve/ortakëve të shoqërisë që ndahet aksionarë apo ortakë të një ose më shumë shoqërive pritëse, në përputhje me raportin e ndarjes, përcaktuar në marrëveshjen e ndarjes;

c) vlerësimin e shoqërisë që ndahet si e prishur dhe çregjistrimin e saj nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, sipas seksionit V të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" pa kryerjen e likuidimit.

Neni 25
Shndërrimi

Shoqëria mund ta ndryshojë formën e vet ligjore, nëpërmjet shndërrimit të saj në shoqëri aksionare. Shndërrimi nuk sjell pasoja mbi të drejtat e detyrimet, që shoqëria ka marrë përsipër ndaj të tretëve.

Neni 26
Baza Liqiore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptarë. Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 27
Mosmarrëveshjet

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të

jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

Neni 28
Dispozita përfundimtare

Ky Akt Themelim u redaktua në 4 ekzemplare me përmbajtje dhe vlera të njëjta juridike, në gjuhën shqipe, miratohet në parim dhe nen për nen nga Ortakët e Shoqërisë tregtare "AR & LU MARMARA" SH.P.K dhe nënshkruhet në të gjitha kopjet.

ORTAKET DHE THEMELUESIT E SHOQËRISË "AR & LU
MARMARA " SH.P.K

Anxhelo GJIKA

Gentjan KKRASHI

